



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Nr. 2813/3 Prot.

Tiranë, më 20 . 10 .2025

Lënda: Dërgohet Plani Strategjik dhe Vjetor i veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm për vitet 2026 - 2028.

MINISTRISË SË FINANCIVE TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KONTROLLIT TË BRENDSHËM
FINANCIAR PUBLIK DHE RAPORTIMIT FINANCIAR
DREJTORISË SË HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr.3; Tiranë

Në zbatim të Ligjit Nr.114, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", të ndryshuar, Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, "Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik", Kap.III "Planifikimi i veprimtarive të Auditimit të Brendshëm", të ndryshuar, si dhe shkresës së Ministrisë së Financave nr.13111 Prot., datë 10.09.2025, Ju dërgojmë bashkëlidhur Planin Strategjik dhe Vjetor të Sektorit të Auditimit të Brendshëm në Universitetin Bujqësor të Tiranës për vitet 2026-2028, të miratuar me Vendimin e Bordit të Administrimit Nr.49, datë 17.10.2025.

Bashkëngjitur Pasyrat me nr.1-nr.5, sipas formatit standard përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Arta Dollani





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
BORDI ADMINISTRIMIT

Nr. 2813/2 Prot

Tiranë, më 17.10.2025

V E N D I M

Nr. 49, datë 17.10.2025

**“PËR MIRATIMIN E PLANIT STRATEGJIK DHE VJETOR TË VEPRIMTARISË
SË SEKTORIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM PËR PERIUdhËN 2026-2028”**


Bordi i Administrimit, mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.7.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin Nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, Kapitullit III të Manualit të Auditimit të Brendshëm miratuar me Urdhrin Nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave, si dhe referuar Kërkesës së Sektorit të Auditimit të Brendshëm të UBT-së me Nr. 2813/1 Prot., datë 15.10.2025, në mbledhjen e tij të datës 17.10.2025,

V E N D O S I :

1. Të miratojë Planin Strategjik dhe Vjetor të veprimtarisë së Sektorit të Auditimit të Brendshëm, në Universitetin Bujqësor të Tiranës për periudhën 2026 – 2028 (sipas dokumentit bashkëlidhur).
2. Ngarkohet për zbatim të këtij vendimi Administratori i Universitetit Bujqësor të Tiranës dhe Sektori i Auditit të Brendshëm..

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

Arta DOLLANI	Kryetar	
Matilda SHABANI	Anëtar	
Edmond KADIU	Anëtar	
Ilir KUSI	Anëtar	
Blerina DUKA	Anëtar	
Altin PRENGA	Anëtar	
Albert KOPALI	Anëtar	





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
SEKTORI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Nr. 2813/1 Prot.

Tiranë, më 15.10.2025

Lënda: Mbi miratimin e Planit Strategjik dhe Vjetor të veprimtarisë së Sektorit të Auditimit të Brendshëm për periudhën 2026-2028.

BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Referuar nenit 116 të Ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; si dhe në zbatim të germës c) të nenit 14 të Ligjit Nr.114, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar; Kapitullit III të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin nr.100, datë 25.10.2016 të Ministrisë të Financave, i ndryshuar, Përgjegjësi i Sektorit të Auditimit të Brendshëm në UBT, ka hartuar Planin Strategjik dhe vjetor për periudhën 2026-2028.

Në zbatim të germës ç) të nenit 12 si dhe germës c) të nenit 14 të Ligjit Nr.114, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar, plani i hartuar strategjik dhe vjetor për periudhën 2026-2028, duhet të miratohet nga Bordi i Administrimit, në cilësinë e Titullarit të Njesisë Publike.

Bashkëngjitur kësaj shkrese keni kopjen e përgatitur të këtij Plani për miratim, së bashku me pasqyrat përkatëse me-nr.1-nr.5.

Referuar germës c) të nenit 14 të Ligjit Nr.114, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar, si dhe çështjes me nr.3.3 të Kapitullit III të Manualit të Auditimit të Brendshëm, i ndryshuar, pas miratimit nga titullari i njesisë publike, plani strategjik dhe vjetor dërgohet jo me vonë se data 20 Tetor e çdo viti në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave.

Ju faleminderit për bashkëpunimin.

PËRGJEGJËS I SEKTORIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Ruska Marku



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
SEKTORI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Tiranë, më 15.10.2025

**Plani Strategjik dhe Vjetor i Veprimtarisë së Sektorit të Auditimit të Brendshëm në
Universitetin Bujqësor Tiranë për periudhën 2026-2028.**

Hyrje

Bazuar në gërmën e, të nenit 14, të Ligjit Nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik", i ndryshuar, si dhe Kapitullit III-Planifikimi i veprimtarive të auditimit të brendshëm, të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave Nr.100, datë 25.10.2016, i ndryshuar, Sektori i Auditimit të Brendshëm në Universitetin Bujqësor, ka hartuar Planin Strategjik 2026 - 2028 dhe Planin Vjetor 2026.

Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT) është institucion publik i arsimit të lartë dhe funksionon sipas Ligjit Nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Universiteti Bujqësor i Tiranës ka në përbërje të tij 5 Fakultete, një Institut kërkimi e zhvillimi dhe njësi ndihmëse, të shërbimit dhe administrative.

Misioni i Universitetit Bujqësor të Tiranës është: "UBT Qendër Ekselence" me një rrugë të përcaktuar qartë për të arritur objektivat, me referencë dhe mbështetjen strategjike të siguruar nga Universiteti i Vjenës (BOKU).

I. Plani Strategjik për periudhën 2026-2028

- Qëllimi i Planit Strategjik, Misioni dhe Vizioni i NJAB.

Qëllimi i Planit Strategjik 2026-2028 është përcaktimi i angazhimeve që do të ndërmerren nga struktura e auditimit të brendshëm të UBT-së për periudhën e ardhshme 3-vjeçare, duke e përditësuar çdo vit këtë dokument, me qëllim përshtatjen të tij me dinamikën e objektivave, synimet e organizatës dhe me burimet njerëzore në dispozicion të shërbimit të auditimit të brendshëm. Në këtë plan strategjik do të programohen veprimtaritë kryesore të planifikuara për t'u kryer në periudhën 2026-2028, me qëllim që të sigurohemi që sistemet/fushat e identifikuara me risk mbulohen me auditim gjatë kësaj periudhe.

Gjatë hartimit të këtij plani strategjik është bërë i mundur optimizimi i gjithë fazave të procesit, duke filluar me universin e auditimit, vlerësimin e riskut, frekuencën e auditimit dhe përlogaritjen e burimeve të auditimit.

Spektori i Auditimit të Brendshëm në Universitetin Bujqësor të Tiranës ka për qëllim të japë siguri objektive, të pavarur dhe të ofrojë shërbime këshillimi për menaxhimin, për të shtuar vlerë dhe përmirësuar veprimtarinë e UBT.

Misioni

Misioni i strukturës së auditimit të brendshëm në UBT është të përmirësojë veprimtarinë e institucionit, duke ndihmuar në arritjen e objektivave, nëpërmjet një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike, për të vlerësuar e përmirësuar frytshmërinë e menaxhimit të riskut si dhe proceset e kontrollit e të qeverisjes në UBT (Rektorat dhe Njësi varësie).

Vizioni

Auditimi i Brendshëm synon të jetë një funksion strategjik, i pavarur dhe profesional që kontribuon në rritjen e integritetit, efikasitetit dhe transparencës në të gjitha strukturat e universitetit. Të jemi një partner i besuar në përmirësimin e qeverisjes universitare, menaxhimit të riskut dhe kontrollit të brendshëm, përmes ofrimit të sigurisë dhe këshillimit të pavarur, që shton vlerë në arritjen e objektivave të Universitetit Bujqësor të Tiranës.

• **Organizimi i NJAB dhe Kuadri ligjor**

Organizimi i NJAB

Njësi e Auditimit të Brendshëm në Universitetin Bujqësor të Tiranës është pjesë e strukturës administrative të institucionit dhe, sipas strukturës organizative të miratuar për vitin 2025 me Vendimin nr.18, datë 14.04.2025, të Bordit të Administrimit, ka përbërjen 1+2, përkatësisht: 1(një) përgjegjës sektori dhe 2 (dy) specialistë.

Spektori i Auditimit të Brendshëm (SAB) është funksionalisht i pavarur dhe raporton në mënyrë të drejtpërdrejtë tek Bordi i Administrimit, në cilësinë e Titullarit të Njësisë Publike.

Kuadri ligjor

Spektori i Auditimit të Brendshëm në UBT, ushtron veprimtarinë mbi këtë bazë ligjore:

- Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe aktet nënligjore në zbatim të Ligjit Për Arsimin e Lartë në RSH.
- VKM Nr.75 datë 12.02.20218 "Për Miratimin e Modelit të Financimit të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor".
- Ligjin Nr. 114/2015 datë 22.10.2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik", i ndryshuar.

- VKM nr 83 datë 03.02.2016 "Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik".
- Manualin për Auditimin e Brendshëm, i miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave Nr. 100, datë 25.10.2016 "Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik", i ndryshuar.
- Kodin e Etikës për Audituesit e Brendshëm në sektorin publik, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave Nr.86, datë 10.12.2015.
- Kartën e Auditimit të Brendshëm, miratuar me Vendimin Nr.59, datë 20.12.2022, të Bordit të Administrimit "Për miratimin e Kartës së Auditimit të Brendshëm të rishikuar në Universitetin Bujqësor të Tiranës".

• **Objektivat strategjike**

Sektori i Auditimit të Brendshëm ka përcaktuar objektivat në funksion të arritjes së objektivave kryesore të Institucionit (UBT), të cilat janë:

- Përmirësimi i cilësisë së arsimit të lartë; Modernizimi i kurrikulave, mësimdhënies dhe metodave të vlerësimit në të gjitha ciklet e studimit, në kuadër të bashkëpunimit UBT-BOKU.
- Integrimi cilësor i programeve të reja, të hapura në kuadër të bashkëpunimit UBT-BOKU.
- Zhvillimi i kapaciteteve kërkimore dhe i inovacionit; Rritja e projekteve shkencore, laboratorëve dhe mbështetjes për publikime.
- Zhvillimi i burimeve njerëzore: Trajnimi i stafit akademik dhe administrativ, promovimi dhe motivimi në bazë të performancës.
- Zgjerimi i bashkëpunimit ndërkombëtar; Rritja e marrëveshjeve me universitete evropiane, shkëmbimeve akademike dhe përfshirjes në projekte ndërkombëtare.
- Mbështetja për studentët: Bursa, shërbime, ndihmë për studentët me aftësi ndryshe dhe reduktim i braktisjes nga studimet.
- Fuqizimi i lidhjes me sektorin bujqësor dhe zhvillimin rural: Programe praktike, trajnime dhe transferim teknologjie në zonat rurale për një zhvillim të qëndrueshëm.
- Rritja e cilësisë së mësimdhënies: Përdorimi i metodave interaktive dhe përmirësimi i mjedisit për studentët.
- Përmirësimi i menaxhimit financiar dhe përdorimit të fondeve: Transparencë, efikasitet dhe planifikim më i mirë buxhetor në përputhje me objektivat strategjik të institucionit.
- Zhvillimi i strukturës akademike dhe kërkimore: Investime në laboratorë, biblioteka, mjete IT, ambiente mësimore dhe qendra kërkimi.

Objektivat e Sektorit të Auditimit të Brendshëm mbeten:

- Përfshirja në planin (1+2) e të gjithë subjekteve, duke u fokusuar në identifikimin e fushave, të cilat kanë ndikim në arritjen e objektivave të Institucionit.
- Vlerësimi i përshtatshmërisë dhe efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm në përmbushje të misionit të UBT, sipas sistemeve/fushave të identifikuara për auditim.
- Programimi dhe kryerja e auditimeve në bazë të planit të miratuar, duke ruajtur frekuencën e auditimit, vlerësimin e riskut dhe nivelin e materialitetit.
- Dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të UBT dhe ndjekja me prioritet e zbatimit të tyre.

• Identifikimi i subjekteve

Duke marrë në konsideratë strukturën funksionale të UBT-së, Sektori i Auditimit të Brendshëm ka identifikuar si subjekte për auditim Rektoratin dhe të gjitha njësitë e varësisë. Këto njësi nuk disponojnë struktura të veçanta të auditimit të brendshëm në organikën e tyre, për këtë arsye, shërbimi i auditimit të brendshëm kryhet nga struktura qendrore e auditimit në Rektoratin e UBT-së.

Shpërndarja e subjekteve të identifikuara për auditim për periudhën trevjeçare është kryer në bazë të një vlerësimi të kombinuar të riskut, kapaciteteve të disponueshme për auditim dhe frekuencën e nevojshme për mbulimin me auditim.

1-Struktura administrative në nivel institucioni: Administratori, Drejtoria Ekonomike dhe Financës, Drejtoria e Fondeve dhe Investimeve dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Juridike, - subjekt i identifikuar është Struktura Administrative e Rektoratit. Ky përcaktim nuk përjashton strukturat e tjera, të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në funksion të të gjitha strukturave në institucion.

Në rast të ndryshimit ose miratimit të strukturave të reja do të përditësohet edhe emërtimi i subjektit të identifikuar.

Njësitë e varësisë Fakultetet dhe subjekte të identifikuara, të cilat konkretisht janë:

- 1- Fakulteti i Bujqësisë dhe i Mjedisit
- 2- Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit
- 3- Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit
- 4- Fakulteti i Shkencave Pyjore
- 5- Fakulteti i Mjekësisë Veterinare
- 6- Institut Kërkimor - subjekti i identifikuar është Instituti i Resurseve Gjenetike.
- 7- Njësi ndihmëse - subjekt i identifikuar është Ferma Didaktike Eksperimentale.
- 8- Drejtoria e Projekteve dhe Zhvillimit - është identifikuar si subjekt pasi të gjitha projektet e fituara nën siglën e UBT do të monitorohen nga kjo drejtori në nivel Institucioni, pa përjashtuar dhe strukturat e tjera të UBT që përfshihen në realizimin e projekteve si Drejtoria Ekonomike dhe Financës dhe Drejtoria e Fondeve dhe Investimeve.

Referuar Subjekteve të identifikuara si më sipër universi i auditimit përbëhet nga 9 (nëntë) subjekte gjithsej, të cilat janë paraqitur në Pasqyrën nr.1, bashkëlidhur këtij dokumenti.

- **Identifikimi i fushave /sistemeve prioritare.**

Përcaktimi dhe kategorizimi i universit të auditimit, i cili përbëhet nga disa sisteme/fusha që do të auditohen, është kryer nga Sektori i Auditimit të Brendshëm, duke njohur veprimtarinë e Institucionit, sipas informacionit të marrë nga planet e mëparshme strategjike, si dhe referuar gjetjeve kryesore nga auditimet e kryera në subjektet e identifikuara.

UBT funksionon si njësi shpenzuese e centralizuar. Në këtë kuadër Nëpunësi autorizues, i cili ka depozituar firmën në thesar është Administratori i UBT-së, ndërsa Nëpunësi zbatues, i cili ka depozituar gjithashtu firmën në thesar është Drejtori i Drejtorisë Ekonomike dhe Financës, pjesë e strukturës administrative në nivel institucioni.

Procedurat e punësimit të personelit të UBT-së administrohen nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Juridike-strukturë ndihmës akademike me karakter administrativ në nivel institucioni, ndërsa procedurat e prokurimeve të larta, janë të përqendruara dhe kryhen nga struktura administrative e Rektoratit të UBT-së, duke përfshirë edhe ato që lidhen me nevojat e njësisë vartëse.

Vlerësimi i përgjithshëm për kontrollin e brendshëm për, Fakultetet dhe Institutin është përcaktuar në nivelin i Mesëm, sipas organizimit të UBT, argumentuar si më sipër.

Nga auditimet e kryera në UBT dhe nga mënyra e strukturimit dhe organizimit të menaxhimit financiar janë identifikuar sistemet kryesore, në të cilat do të fokusohet veprimtaria audituese. Në subjektet e vlerësuara me risk të lartë si Struktura Administrative e Rektoratit janë identifikuar për auditim këto sisteme;

- Sistemi i programimit dhe zbatimit të buxhetit
- Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore
- Sistemi i krijimit dhe përdorimit të të ardhurave dytësore;
- Sistemi i pagesave
- Sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar, duke përfshirë detyrimet e prapambetura dhe menaxhimin e aktiveve.
- Sistemi i prokurimeve/investimeve (sepse procedurat e prokurimeve kryhen nga struktura e rektoratit në nivel institucioni, pa përfshirë procedurat e prokurimit me vlerë të vogël që kryhen nga Fakultetet).

Në Fermën Didaktike Eksperimentale, janë identifikuar për auditim këto fusha:

- Sektori i prodhimit bujqësor.
- Sektori i blegtorisë.

Në subjektet e vlerësuara me risk të mesëm, kryesisht Fakultetet si: Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit, Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit, Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit

Fakulteti i Shkencave Pyjore, përjashtuar Fakultetin e Mjekësisë Veterinare, i cili është vlerësuar me risk të lartë, referuar gjetjeve të auditimit të kryer gjatë vitit 2025, janë identifikuar për auditim këto sisteme kryesore:

- Sistemi i programimit dhe zbatimit të buxhetit.
- Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore.
- Sistemi i krijimit dhe përdorimit të të ardhurave dytësore.
- Sistemi i pagesave (ku do të auditohen dhe procedurat e prokurimit me vlerë të vogël pasi nuk është identifikuar si sistem më vete për arsye të numrit të ulët të procedurave/transaksioneve).
- Sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar, duke përfshirë detyrimet e prapambetura dhe menaxhimin e aktiveve.

Instituti i Resurseve Gjenetike të Bimëve i vlerësuar me risk të mesëm ku janë identifikuar për auditim këto fusha:

- Koleksioni i Bankës Gjenetike
- Koleksioni fushor.

Në Drejtorinë e Projekteve dhe Zhvillimit e vlerësuar gjithashtu me risk të mesëm është identifikuar si sistem:

- Sistemi i projekteve, ku do të përfshihen të gjitha njësitë e varësisë si përfituese të projekteve.

Pavarësisht se në pasqyrat bashkëlidhur Nr.1 dhe Nr.3 nuk është përcaktuar si sistem i identifikuar, në çdo angazhim auditimi një nga drejtimitet e auditimit do të jetë; Vlerësimi i komponentëve të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

• Identifikimi dhe vlerësimi i risqeve

Identifikimi dhe vlerësimi i përgjithshëm i riskut është kryer pas rishikimit të Formatit Standard Nr.1- Pyetësor vlerësimi për kontrollin e brendshëm dhe Formatit Standard Nr.2-"Pyetësori për Planin Strategjik –Të kuptosh procedurat e Auditimit të Brendshëm".

Identifikimi dhe vlerësimi i përgjithshëm i riskut është bazuar jo vetëm në rishikimin e këtyre Formateve Standard, por i është referuar edhe gjetjeve nga auditimi i brendshëm.

Gjithashtu gjatë hartimit të planit strategjik për periudhën 2026-2028, vlerësimi i riskut është bërë mbi bazën e shqyrtimit të faktorëve, si: Rëndësia dhe madhësia e subjektit të audituar; materialiteti dhe kompleksiteti i transaksioneve; ndryshimi; mbikqyrje e dobët e menaxhimit; pikëpamjet e menaxhimit; frekuenca e auditimit, të cilët kanë mundësinë më të madhe për të shkaktuar një ngjarje të papritur dhe duke u dhënë prioritet sigurisht fushave të cilat kanë mundësinë më të lartë për të patur një ndikim negativ nga ndodhja e kësaj ngjarjeje.

Për sa theksuam më sipër është bërë i mundur identifikimi i një pjese të mirë të risqeve kryesore, sipas sistemeve/fushave/subjekteve si më poshtë:

Sistemi i menaxhimit buxhetor

- Mungesa e ekipit të menaxhimit të programit (EMP)
- Mungesa e përcaktimit të objektivave strategjik dhe vjetor gjatë programimit të fondeve buxhetore nga njësitë e varësisë.
- Mungesa e argumentimit gjatë planifikimit të fondeve buxhetore.
- Mosrespektim i plotë i parimit të disiplinës fiskale sipas ligjit organik për menaxhimin e sistemit buxhetor gjatë hartimit të PBA.(Planifikimi i shpenzimeve i pabazuar në flukset hyrëse të parasë).
- Menaxhim jo efektiv i fondeve buxhetore nga të ardhurat dytësore.
- Mungesa e rregullave të qarta dhe të dokumentuara me gjurmë audituese për procesin e hartimit dhe zbatimit të buxhetit.

Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore

- Mungesa e rishikimit të rregulloreve të brendshme të çdo sektori apo drejtorie.
- Mungesa e rishikimit të përshkrimeve të punës së punonjësve.

Sistemi i krijimit dhe përdorimit të të ardhurave dytësore

- Aplikimi i gabuar i tarifave (krediteve) për studentët përsëritës.
- Studentë debitorë pa kryer pagesën e tarifës vjetore të shkollimit.
- Mungesa e zbatimit të tarifave të miratuara nga shërbimet në klinikën veterinare.

Sistemi i prokurimeve publike

- Anullimi i shpeshtë i procedurave të prokurimit.
- Mungesë transparence në vendosjen e kriterëve për kualifikim që sjell kufizimin e pjesëmarrësve në procedurat e prokurimit publik.
- Mungesa e kontrolleve efektive gjatë zbatimit të kontratave.

Fusha e ankandëve publike

- Mungesa e zbatimit të aktiviteteve efektive të kontrollit të gjurmës së auditimit sipas përcaktimeve të akteve ligjore e nënligjore.
- Mungesa e sigurimit të kontratave të shitjeve me ankand, mundësi për mos përmbushjen e detyrimeve kontraktore nga subjektet.

Sistemi i Kontabilitetit dhe Raportimit financiar

- Mangësi në drejtim të klasifikimit të AQT në regjistrin e aktiveve dhe përlllogaritjes së amortizimit.
- Mangësi në procedurat e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve
- Pajisje jashtë përdorimit pa ndjekje të procedurave ligjore.
- Mungesa e finalizimit të procesit të inventarizimit të aktiveve sipas periudhave raportuese.
- Mungesa e grumbullimit të aktiveve të vlerësuara për jashtë përdorimit në ambiente të posaçme për asgjësim, rrit rrezikun e përdorimit të paautorizuar ose humbjes së tyre.

- Detyrime të krijuara ndër vite pa ndërmarrë asnjë veprim për arkëtimin apo sistemin e tyre.
- Mungesë transparence në përdorimin e karburantit që menaxhohet nëpërmjet sistemit elektronik të kartave.
- Mungesa e gjurmës së auditimit për menaxhimin e karburantit;
- Mungesa e specialistëve të fushës për vlerësimin e mjeteve të transportit dhe aktiveve biologjike.
- Mallra stoqe në magazinën qendrore.
- Rritja e stokut të detyrimeve të prapambetura.
- Mungesa e klasifikimit të detyrimeve për projekte sipas kategorive përkatëse dhe mungesa e argumentimit për arsyet e krijimit të tyre.
- Nuk është ndjekur parimi i radhës së pagesave, për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura;
- Mangësi në raportimin e detyrimeve të prapambetura.

Sistemi i Pagesave

- Pagesa të vonuara përtej 30 ditëve nga data e faturës origjinale të OE.
- Mungesa e rishikimit të urdhërit të brendshëm lidhur me pagesat për rimbursimin e telefonave celular të drejtuesve për tu përshtatur me bazën ligjore aktuale.

Sistemi i menaxhimit të projekteve

- Mungesa e një strukture me personel me kohë të plotë për menaxhimin e projekteve.
- Mungesa e regjistrimit të riskut.
- Mungesa e gjurmës së auditimit për projektet.
- Mungesa e parashikimit të fondeve për rimbursimin e TVSH.
- Mungesë transparence në detajimin e kohës së shpenzuar nga stafi për projektet me kohën jo projekte.
- Likuidimi i kostove të pa pranueshme nga fondet IPA II 2014-2020
- Mangësi në pasqyrimin e financave të projektit dhe në raportimin e tyre në Ministrinë e Financave.

Ferma Didaktike Eksperimentale

- Mungesa e rishikimit të rregullores së brendshme.
- Mungesa e regjistrimit të riskut.
- Mungesa e rregullave specifike lidhur me prodhimin e nënprodukteve.
- Risqet që lidhen me aspektin didaktik; mungesa e rregullave specifike për procesin e punës Didaktike Eksperimentale dhe mungesa e planeve të punës didaktike eksperimentale.

• **Kufizimet e Auditimit**

Një nga kufizimet kryesore me të cilat përballlet Sektori i Auditimit të Brendshëm është mungesa e bashkëpunimit të plotë nga strukturat përkatëse të institucionit, përfshirë vonesa në dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar, mungesën e dokumentacionit mbështetës për realizimin e auditimit të plotë të sistemeve, si dhe mungesën e gjurmës së auditimit për disa sisteme/fusha si; për buxhetin, projektet, menaxhimin e karburantit nëpërmjet sistemit elektronik të kartave. Gjithashtu ndërprerja e auditimeve për shkak të kërkesave specifike të menaxhimit ka ndikuar në vazhdimësinë e proceseve audituese. Këto kufizime kanë ndikuar dhe në zgjatjen e auditimeve përtej afatit të parashikuar.

Sikurse është theksuar edhe në disa dokumente të mëparshme të Sektorit të Auditimit të Brendshëm, vendosja në dispozicion e vendimeve të Bordit të Administrimit do ishte shumë e dobishme në efektivitetin e punës së këtij sektori.

Theksojmë se Sektori i Auditimit të Brendshëm mund të përballlet me kufizime të ndryshme gjatë ushtrimit të funksioneve të tij, për shkak të kompleksitetit dhe specifikave të ndryshme që paraqesin njësitë e institucionit.

- **Prioritet për vitet (1+2)**

Veprimtaria audituese e Sektorit të Auditimit të Brendshëm në Universitetin Bujqësor të Tiranës për vitet 2026-2028, do të përqendrohet në kryerjen e angazhimeve të auditimit, sipas programimit duke optimizuar burimet e auditimit me universin e auditimit, vlerësimin e riskut dhe frekuencën e auditimit.

Sipas vlerësimit të riskut, prioritet është auditimi i sistemeve të identifikuara me risk të lartë.

Një tjetër prioritet në punën audituese për vitet 2026-2028 mbetet identifikimi dhe menaxhimi i riskut në kontrollet e brendshme të subjekteve që auditohen nëpërmjet rekomandimeve dhe ndjekjes së zbatimit të tyre.

Një prej sfidave kryesore të shërbimit të auditimit të brendshëm është fillimi i implementimit të auditimeve të performancës, nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme me ekspertë të fushës.

PLANI VJETOR 2025

- **Zhvillimet aktuale të NJAB**

Sektori i AB për vitin 2025 ka planifikuar 4 (katër) misione angazhimi auditimi, nga të cilat 3 (tre) misione auditimi të kombinuara (financiar dhe përputhshmërie) dhe 1 (një) mision auditimi për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve.

Referuar planit të miratuar nga Sektori i Auditimit të Brendshëm deri më tani është realizuar 1 (një) mision angazhimi mbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeve dhe është në proces auditimi i zbatimit të kontratës "Dixhitalizimi i të gjitha të dhënave në nivel Universiteti". Gjithashtu gjatë kësaj periudhë janë kryer dhe 2 (dy) misione auditimi, të cilat janë raportuar në proces gjatë vitit 2024, konkretisht; Fakulteti i Mjekësisë Veterinare dhe Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit, i cili është në fazën e raportimit. Për shkak të kërkesës së

menjëherëshme të menaxhimit për auditimin e zbatimit të kontratës "Dixhitalizimi i të gjitha të dhënave në nivel Universiteti", duke marrë në konsideratë që periudha e mbetur deri në fund të vitit 2025 është e kufizuar, dhe burimet njerëzore janë të përcaktuara sipas planit ekzistues, Sektori i Auditimit të Brendshëm gjykoj domosdoshmërinë e rishikimit të planit fillestar vjetor të miratuar për vitin 2025. Ky rishikim u krye sipas përcaktimeve të bëra në çështjen 3.5 "Rishikimi i planeve strategjike dhe vjetor të auditimit të brendshëm", të Kapitullit III "Planifikimi i veprimtarive të auditimit të brendshëm", të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016 "Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar.

Sipas këtij rishikimit, rezulton se auditimi i kontratës "Dixhitalizimi i të gjitha të dhënave në nivel Universiteti" do të realizohet në vend të auditimit të Fermës Didaktike Eksperimentale.

• **Prioritetet e auditimit për vitin 2026**

Prioritet i auditimit për vitin 2026, mbetet fokusimi në sisteme dhe fusha llogarie të cilat janë vlerësuar me risk të lartë.

Referuar vlerësimit të riskut, Struktura Administrative e Rektoratit dhe Ferma Didaktike Eksperimentale si subjekte me risk të lartë janë planifikuar për auditim gjatë vitit 2026.

Gjatë përgatitjes së planit vjetor 2026, përveç identifikimit të sistemeve dhe fushave të vlerësuara me risk të lartë, ka qenë prioritet edhe identifikimi i subjekteve, vlerësimi i riskut të të cilave është në nivelin i mesëm dhe identifikimi i subjekteve sipas frekuencës së auditimit.

Gjithashtu gjatë vitit 2026, prioritet mbetet kryerja e angazhimeve të auditimit sipas planifikimit, si dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së shërbimit të auditimit të brendshëm, për të mos mbartur vitin pasardhës angazhime të parealizuara në përmbushje të plotë të këtij planifikimi

• **Objektivat kryesore për vitin 2026**

Objektivat kryesore për vitin 2026, bazuar në subjektet dhe fushat e identifikuara për auditim, janë si vijon:

- Të vlerësojë nëse sistemet e identifikuara për auditim po veprojnë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe me objektivat specifike të vendosura nga Institucioni.
- Vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm nëpërmjet komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe përmirësimin e tij nëpërmjet dhënies së rekomandimeve.
- T'i japë prioritet fushave të vlerësuara me risk të lartë.
- Të kryejë auditime në bazë të planit të miratuar në përputhje me Standardet Globale të Auditimit të Brendshëm (GIAS), Kartën e Auditimit, Kodin e Etikës dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi për fushën e auditimit të brendshëm.

• **Programimi i llojit të angazhimeve**

Programimi i llojit të angazhimeve është bërë duke iu referuar organizimit të UBT-së, mbështetur në eksperiencën e krijuar në vite lidhur me identifikimin e sistemeve që operojnë brenda institucionit, duke pasur parasysh aktet ligjore e nënligjore, mbi bazën e së cilës funksionon institucioni dhe njësitë e varësisë, fondet e alokuara për shpenzimet operative, transfera korente të brendshme, duke konsideruar edhe numrin e punonjësve, është programuar lloji i angazhimit të auditimit dhe sistemet, të cilat do të mbulohen me auditim.

Referuar formatit standard të Pasqyrës Nr.3, si dhe nisur nga eksperiencia e viteve të mëparshme gjatë vitit 2026 Sektori i Auditimit të Brendshëm ka planifikuar për të kryer 4 (katër) angazhime auditimi, prej të cilave 3 (tre) janë auditime të kombinuara, pra do të kryhen auditime të shërbimeve të sigurisë, mbi bazë sistemi, të cilat do të konsistojnë në ato fusha/sisteme që paraqesin risk të lartë dhe që kërkojnë më shumë kohë për të kryer auditimin dhe 1(një) është auditim i verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të lëna gjatë vitit 2025.

Në Strukturën Administrative të Rektoratit pavarësisht se në Pasqyrën nr.1 janë identifikuar të gjitha sistemet, në planin vjetor bazuar në nivelin e riskut dhe frekuencën e auditimit është parashikuar për auditim; Sistemi i prokurimeve të mallrave, shërbimeve dhe investimeve dhe procedurat me ankand, në Drejtorinë e Fondeve dhe Investimeve.

Gjatë vitit 2026 referuar nivelit të riskut është planifikuar për auditim edhe Ferma Didaktike Eksperimentale, e cila ka në përbërje 2(dy) sektor; sektori i prodhimit bujqësor dhe sektori i blegtorisë.

Nisur nga ndryshimet që po ndërmerren aktualisht në Universitetin Bujqësor të Tiranës, në funksion të përshtatjes me modelin e Universitetit BOKU në Vjenë, është planifikuar që gjatë vitit 2026 të auditohet Drejtoria e Projekteve dhe Zhvillimit.

Megjithëse kjo drejtori është vlerësuar me nivel të mesëm risku, bazuar në gjetjet e auditimit të mëparshëm, fokusi i auditimit do të jetë mbi projektin me titull "Strategjia UBT-BOKU 2030".

Në çdo program angazhimi, pavarësisht se nuk është përfshirë në Pasqyrën nr.1 dhe Pasqyrën nr.2 bashkëlidhur, një prej drejtimeve të auditimit do të jetë Vlerësimi i komponentëve të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

● **Planifikimi i kostos për vitin 2026**

Kostoja e auditimit për vitin 2025 është përlllogaritur sipas përcaktimit të bërë në Udhëzuesin/shpjeguesin mbi plotësimin e Pasqyrës Nr.5, të Manualit të Auditimit të Brendshëm. Në zërin "paga dhe sigurime shoqërore", është përlllogaritur paga e një viti buxhetor sipas tërësive aktual të pagave dhe sigurimeve shoqërore për përgjegjësin e sektorit dhe dy specialistë, referuar strukturës faktike të njësisë tonë, dhe VKM nr.325, datë 31.05.2023 "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit dhe funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike" dhe udhëzimit nr.16 datë 16.06.2023.

Në zërin "të tjera" janë pasur parasysh kryesisht shpenzimet e kryera për kancelari, shtypshkrime pajisje kompjuterike dhe bojë printeri.

Për sa i përket zërit "shpenzime udhëtimi & dieta" nuk janë planifikuar shpenzime pasi të gjitha subjektet që do të auditohen ndodhen brenda territorit të institucionit.

- **Planifikimi i burimeve për vitin 2026**

Planifikimi i burimeve të auditimit për vitin 2026 është përgatitur mbi bazën e burimeve njerëzore aktuale në dispozicion, pra me 3 (tre) punonjës.

Referuar përlogaritjes së burimeve sipas Pasqyrës Nr.5, për vitin 2026 numri i ditëve të planifikuara është 198 ditë/person dhe numri i auditimeve është 4 auditime gjithsej, të cilat do të synohen të realizohen.

Gjatë kryerjes së angazhimeve vjetore nga struktura e AB do të synohet ruajtja e qëllimit të auditimit nëpërmjet ruajtjes së parimit të pavarësisë funksionale dhe organizative, duke raportuar drejtpërdrejt te Bordi i Administrimit, në cilësinë e Titullarit të Njesisë Publike dhe në asnjë rast nuk mund të ngarkohet me detyra të tjera operative brenda subjektit, që nuk kanë lidhje me funksionin e auditimit, ashtu sikurse nuk mund të jenë në përbërje të strukturave të tjera operative të subjektit.

- **Planifikimi i nevojave të stafit për trajnim**

Një nga prioritetet e Sektorit të Auditimit të Brendshëm për vitin 2026 është dhe forcimi i kapaciteteve njerëzore nëpërmjet trajnimit të vazhdueshëm profesional, i cili ndikon në drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së shërbimit të auditimit.

Duke vlerësuar mbështetjen e Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave, nëpërmjet trajnimeve të organizuara prej saj, dhe pas miratimit të Standardeve Globale të Auditimit të Brendshëm (GIAS) të pranura për zbatim në sektorin publik në Republikën e Shqipërisë, konsiderohet i domosdoshëm trajnimi për zbatimin e këtyre standardeve gjatë kryerjes së angazhimeve të auditimit.

Për këtë arsye, janë identifikuar temat për trajnim, sipas pasqyrës Nr.4, si vijon:

1.Zbatimi i standardeve të reja të auditimit të brendshëm (GIAS) në sektorin publik, për një shërbim efektiv të auditimit të brendshëm.

2.Udhëzime praktike për zbatimin e GIAS gjatë planifikimit, kryerjes dhe raportimit të angazhimeve të auditimit.

- **Sigurimi i brendshëm i cilësisë**

Sigurimi i brendshëm i cilësisë së punës në Sektorin e Auditimit të Brendshëm realizohet bazuar në Standardet 1300 dhe 1310 të Standardeve Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm, të pranura për tu zbatuar në Republikën e Shqipërisë, si dhe në Programin e Sigurimit të Cilësisë, të miratuar nga Bordi i Administrimit me Vendimin nr.46, datë 14.06.2019 (nr.1604/1 prot., datë 14.06.2019). Një ndër objektivat e Sektorit të Auditimit të Brendshëm (SAB) do të jetë dhe përmirësimi i vazhdueshëm i sigurimit të brendshëm të cilësisë,

sipas përcaktimeve të Programit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë gjatë angazhimeve, si dhe rishikimi i këtij programi në përputhje me Standardet Globale të Auditimit të Brendshëm (GIAS).

Bashkëngjitur janë pasqyrat të cilat pasqyrojnë me në detaje aktivitetin e punës së Sektorit të Auditimit të Brendshëm për vitin 2026, si dhe planifikimi strategjik për vitet (1+2) 2026 - 2028.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

Përgjegjës i Sektorit të Auditimit të Brendshëm

Ruska Marku



Vlerësimi i nivelit të riskut për subjektet që do të auditohen nga NJAB

		VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I RISKUT			
Nr	Subjekte për tu audituar	I lartë	I mesëm	I ulët	
a.	1	3	4	5	
1	Struktura Administrative e UBT(Rektorati)	Sistemi i programimit dhe zbatimit të buxhetit	I mesëm		
		Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore	I mesëm		
		Sistemi i krijimit dhe përdorimit të të ardhurave dytësore	I lartë		
		Sistemi i prokurimeve të mallrave, shërbimeve dhe investimeve dhe procedurat me ankaand.	I lartë		
		Sistemi i pagesave	I mesëm		
		Sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar, duke përfshirë detyrimet e prapambetura dhe menaxhinin e aktiveve	I lartë		
		Sistemi i programimit dhe zbatimit të buxhetit	I lartë		
		Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore	I mesëm		
		Sistemi i krijimit dhe përdorimit të të ardhurave dytësore	I mesëm		
		Sistemi i pagesave		I ulët	
2	Fakulteti Bujqësisë dhe Mjedisit	Sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar, duke përfshirë detyrimet e prapambetura dhe menaxhinin e aktiveve	I lartë		
		Sistemi i programimit dhe zbatimit të buxhetit		I mesëm	
		Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore		I mesëm	
		Sistemi i krijimit dhe përdorimit të të ardhurave dytësore		I mesëm	
		Sistemi i pagesave		I mesëm	
3	Fakulteti Ekonomisë dhe Agrobiznesit	Sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar, duke përfshirë detyrimet e prapambetura dhe menaxhinin e aktiveve	I lartë		
		Sistemi i programimit dhe zbatimit të buxhetit		I mesëm	
		Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore		I mesëm	
		Sistemi i krijimit dhe përdorimit të të ardhurave dytësore		I mesëm	
		Sistemi i pagesave		I mesëm	
	Fakulteti Bioteknologjisë dhe	Sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar, duke përfshirë detyrimet e prapambetura dhe menaxhinin e aktiveve	I lartë		
		Sistemi i programimit dhe zbatimit të buxhetit	I lartë		
		Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore		I mesëm	
		Sistemi i krijimit dhe përdorimit të të ardhurave dytësore		I mesëm	

4	Ushqimit	Sistemi i pagesave			I ulët
		Sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar, duke përfshirë detyrimet e prapambetura dhe menaxhimin e aktiveve	I lartë		
		Sistemi i programimit dhe zbatimit të buxheut	I lartë		
		Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore		I mesëm	
		Sistemi i krijimit dhe përdorimit të të ardhurave dytësore		I mesëm	
		Sistemi i pagesave		I mesëm	
		Sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar, duke përfshirë detyrimet e prapambetura dhe menaxhimin e aktiveve		I mesëm	
		Sistemi i programimit dhe zbatimit të buxheut	I lartë		
		Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore		I mesëm	
		Sistemi i krijimit dhe përdorimit të të ardhurave dytësore	I lartë		
		Sistemi i pagesave		I mesëm	
		Sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar, duke përfshirë detyrimet e prapambetura dhe menaxhimin e aktiveve.	I lartë		
7	Instituti i Resurseve Gjenetike	Koleksioni i Bankes Gjenetike		I mesëm	
		Koleksioni Fushor		I mesëm	
8	Ferma Didaktike Eksperimentale	Sektori i prodhimit bujqësor	I lartë		
		Sektori i blegtorisë	I lartë		
9	Drejtoria e Projekteve dhe Zhvillimit	Sistemi i projekteve (Auditim në nivel horizontal në të gjitha njësitë kryesore të UBT mbi projektet kërkimore shkencore).		I mesëm	

Drejtimi i NJAB, Ruska Marku



Plani strategjik i subjekteve të synuara për tu audituar për vitet 2026- 2028

SUBJEKTE TË SYNUARA PËR TU AUDITUAR SIPAS VITEVE						
Nr	Viti planifikuar 2026	Niveli i Riskut (V. planifikuar)	Viti I planif+1 2027	Niveli i Riskut (V. planif.+1)	Viti I planif+2 2028	Niveli i Riskut (V. planif.+2)
a:	1	2	3	4	5	6
1	Ferma Didaktike Eksperimentale	I lartë	Struktura Administrative e Rektoratit	I lartë	Struktura Administrative e Rektoratit	I lartë
2	Struktura Administrative e Rektoratit	I lartë	Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit	I mesëm	Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit	I mesëm
3	Drejtoria e Projekteve dhe Zhvillimit	I mesëm	Fakulteti i Shkencave Pyjore	I mesëm	Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit	I mesëm
4	Verifikim i zbatimit të rekomandimeve (2025)		Instituti i Resurseve Gjenetike	I mesëm	Fakulteti i Mjekësisë Veterinare	I lartë
5			Verifikim i zbatimit të rekomandimeve (2026)		Verifikim i zbatimit të rekomandimeve (2027)	

Drejtuesi i NJAB, Ruska Marku



SEKTORI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË UNIVERSITETIN BUJQËSOR TË TIRANËS

Plani i angazhimeve të NJAB për vitin 2026

Pasqyra 3

Nr	Subjekte të synuara për tu audituar	Fusha për tu audituar	Auditime Gjithsej	Shërbimet e Sigurisë					Shërbimet e konsultimeve	Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve	Grupi i Auditimit (nr. auditues)
				A. të përputhshmërisë	A. të performancës	Financiare	A.tek.Informacioni	A. të kombinuara			
a.	1	2	3	4.1	4.2	4.3	4.4	4.5	4.6	4.7	5
1	Ferma Didaktike Eksperimentale	Sektori i prodhimit bujqësor Sektori i blegtorisë	1					1			2
2	Struktura Administrative e Rektoratit	Sistemi i prokurimeve të mallrave, shërbimeve dhe investimeve dhe procedurat me ankand	1					1			2
3	Drejtoria e Projekteve dhe Zhvillimit	Sistemi i projekteve (Auditim në nivel horizontal në të gjitha njësitë kryesore të UBT mbi projektet kërkimore shkencore).	1					1			2
4	Verifikim i zbatimit të rekomandimeve (2025)		1							1	2
	SHUMA		4	0	0	0	0	3		1	2

Drejtuuesi i NJAB, Ruska Marku



SEKTORI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË UNIVERSITETIN BUQËSOR TË TIRANËS

Pasqyra 4

Planifikimi vjetor i nevojave për trajnim të NJAB për vitin 2026

Nr	TEMATIKA E IDENTIFIKUAR PËR TRAJNIM	Pjesëmarrës në trajnim (nr.personave)	Periodha (gjatë vitit)	Kohezgjatja e trajnitit (në ditë)
a.	1	2	3	4
1	Zbatimi i standardeve të reja të auditimit të brendshëm-GIAS në sektorin publik për një shërbim efektiv të auditimit të brendshëm.	3(tre)	Janar-shkurt	3(tre)
2	Udhëzime praktike për zbatimin e GIAS gjatë planifikimit, kryerjes dhe raportimit të angazhimeve të auditimit.	3(tre)	Janar-shkurt	2(dy)
	SHUMA	3		5

Drejtuessi i NJAB, Ruska Marku



SEKTORI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË UNIVERSITETIN BUJQËSOR TË TIRANËS

Pasqyra 5

Planifikimi vjetor i buxhetit dhe shpërndarja e burimeve të NJAB për vitin 2026

000/mijë lekë

BURIMET E PLANIFIKUARA			BUXHETI I PLANIFIKUAR		
Nr Shpërndarja e Burimeve Njerëzore të NJAB	Ditë për tregues	Përlogaritja e burimeve	Nr Treguesit e Kostos së Burimeve Njerëzore të NJAB	Plani	
1	2	3	1	2	
1 Koha maksimale e vlefshme	780	52 javë x 5 ditë/javë x 3 punonjës	1 Buxheti Gjithsej	5,518	
2 Pashime Vjetore	66	22 ditë/person x 3 punonjës	2 Paga dhe Sig. Shoqërore	5,318	
3 Dite pushimi (Festa Zyrtare)	45	15 ditë/person x 3 punonjës	3 Shpenzime Udhëtimi & Dieta	0	
4 Pushime për arsye shëndetësore	15	5 ditë/person x 3 punonjës	4 Të tjera	200	
5 Angazhime në trajnime	30	10 ditë/person x 3 punonjës	5 Numri i Punonjësve	3	
6 Angazhime në mbledhje/takime	15	5 ditë/person x 3 punonjës	6 Kosto për Person (1/5)	1,839	
7 Rezerva të Planifikuara (të papritura)	15	5 ditë / person x 3 punonjës			
TOTALI	594	198 ditë për person			

Drejtuesi i NJAB, Ruska Marku

